



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 393/4 prot.

Tiranë, më 22._08. 2023

V E N D I M

Nr._166_, datë 22._08. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, shqyrtoi ankesën Nr. 42 regj, datë 16.03.2023, të paraqitur nga z. H.Çnë emër të vajzës së tij të mitur A.Ç, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, z. Ç, pretendon se vajza e tij A.Ç është diskriminuar pasi nuk ka përfituar si të gjithë personat e tjerë me aftësi të kufizuar ndihmat financiare që janë dhënë nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Z. Ç shpjegon në ankesën e paraqitur se, vajza e tij ka qenë në Komisionin Epror nga data 01.03.2022 deri në datë 15.12.2022. Komisioni Epror ka vlerësuar se vajza e tij A.Ç është invalide e grupit të dytë. Gjatë periudhës që rasti i vajzës ka qenë në Komision Epror, por edhe më pas, të gjithë personat me aftësi të kufizuar kanë përfituar 3 muaj nga 3.000 (tre mijë) lekë, 6.000 (gjashtë mijë) lekë për fundvit dhe 8.000 (tetë) mijë lekë pakoja e madhe, ndërsa vajza e tij A.Ç nuk ka përfituar, për faktin se nuk ishte në listën e muajit si përfituese.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Z. Ç pretendon se vajza e tij A.Ç është diskriminuar duke mos përfituar ndihmat financiare që janë dhënë për personat me aftësi të kufizuara, pasi sëmundja e saj u konfirmua nga KMCAP dhe të gjithë muajt e KEMP-it i janë dhënë, ndërsa ndihmat e caktuara me VKM nuk i janë dhënë. Sipas z. Ç, vajza e tij është diskriminuar për shkak se institucionet shtetërore kanë zgjatur në kohë procedurën e komisionimit dhe në këtë mënyrë ajo është shkëputur me pa të drejtë nga lista si përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar.

Përfundimisht, z. Ç kërkon nga Komisioneri që vajza e tij A.Ç të marrë përfitimet që i janë mohuar pa të drejtë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.393/1 prot datë 29.03.2023, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë (DRSHSSH Korçë), në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë. Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion ka

kthyer përgjigje DRSHTSH Korçë, nëpërmjet shkresës nr.538/1 prot datë 04.04.2023, duke parashtruar si vijon:

Ndihmat financiare të pretenduara nga pala ankuese janë akorduar nëpërmjet:

- VKM nr.159, datë 12.03.2023 *“Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”*, ku kategori të caktuara kanë përfituar mbështetje financiare tre mujore përkatësisht prill, maj dhe qershor.
- VKM nr.754, datë 01.12.2022 *“Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2022”*, pika 1, germa “b”, ku citohet se përfitojnë në masën 3000 (tre mijë) lekë *“Familjet të cilat kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”*.
- VKM nr.899, datë 29.12.2022 *“Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e impaktit të krizës”*, pika 1, germa “c”, përfitojnë 8000 (tetë mijë) lekë, ku citohet: *“Familjet të cilat kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”*.

Ndihmat financiare të pretenduara nga ankuesi për të bijën A.Ç, janë miratuar me VKM nr.159, datë 12.03.2022, VKM nr.754, datë 01.12.2022 dhe VKM nr.899, datë 29.12.2022. Gjatë periudhës që janë akorduar fondet për këto kategori të përcaktuara në VKM-të përkatëse dosja e fëmijës ka qenë ende në shqyrtim. Pra, fëmija ka dalë në komisionin epror në datë 15.12.2022. Bazuar në VKM nr.182, datë 26.02.2020 *“Për përcaktimin e masës, kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe ndihmësit personal”*, i ndryshuar, Kreu IV, pika 9, ku citohet: *“Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për personat aplikues, hedhin në arkivin elektronik, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e vlerësimit/rivlerësimit, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative, të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person”* dhe pikës 10, ku citohet: *“Administratori shoqëror, në bazë të vendimeve të komisionit, përgatit listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me masën e përfitimit për çdo përfitues, përfshirë edhe përfitimet shtesë, të bazuara në dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë i dërgohet çdo muaj strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki për të kryer pagesat”*, pra duke marrë parasysh që dosja ka qenë ende në rivlerësim, emri i A.Çt nuk është vendosur në borderonë e muajve përkatës që ndihmat financiare kanë qenë të vlefshme.

Bazuar në urdhrin nr.577, datë 14.10.2020 *“Për një ndryshim dhe shtesë në urdhrin nr.266/1 datë 01.09.2020, “Për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”*, fëmija A.Ç është komisionuar në datën 08.02.2022 me vendimin nr.711, të

KMCAP, niveli i parë neurologji-kirurgji, duke u vlerësuar pa grup. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec është dërguar ankesa datë 13.04.2022 dhe është rikomisionuar në KMCAP Epror P/T, datë 15.12.2022 duke u vlerësuar grupi i dytë. Dosja e saj ka mbërritur në DRSHSSH Korçë, në datë 13.01.2023, me shkresën nr.381 prot, datë 12.01.2023. Pasi është skanuar, dosja është dërguar në zyrën e Bashkisë Pogradec, me shkresën e datës 18.01.2023 me nr.50/1 prot.

Bazuar në ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”, persona me aftësi të kufizuar janë individët, të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime, që, në bashkëveprim me pengesa të ndryshme, përfshirë ato mjedisore e të qendrimit, mund të pengojnë pjesmarrjen e plotë dhe efikase të tyre në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët, siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.

Përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar personat e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 8, të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”. Akti në të cilin përcaktohet masa e përfitimit, kriteret dhe procedurat e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar është VKM nr.182, datë 26.02.2020. Në kreun IV të VKM nr.182, datë 26.02.2020, përcaktohen procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin për shkak të aftësisë së kufizuar. Sipas Kreut III, pika 12, citohet se, personave me aftësi të kufizuar, të cilët vlerësohen për herë të parë në KMCAP u lind e drejta e përfitimit të pagesës në muajin pasardhës nga data e marrjes së vendimit nga ky komision. Për individët dosjet e të cilëve janë në rivlerësim në KMCAP Epror, të cilësuar pa grup dhe me divergjencë vendimi nuk ka fuqi ligjore ekzekutive, por pagesat mujore të cilësuar në VKM nr.182, datë 26.02.2020, përfitohen në momentin që KMCAP Epror merr vendimin përfundimtar. Vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë dhe pagesat sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim.

Për sa i përket shpërblimit të fundvitit dhe mbështetjes financiare siç është cituar dhe më sipër duke qenë se dosja e fëmijës A.Ç ka qenë ende në ndjekje të procedurave të rivlerësimit nuk është vendosur në borderonë e muajve përkatës për të cilat është akorduar fondi. DRSHSSH Korçë dhe SHSSH nuk kanë diskriminuar të miturën A.Ç.

2. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 393/3 prot., datë 30.05.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datë 13.06.2023 ora 10:00, me pjesmarrjen e znj. F.D dhe z. E.LI, punonjës të Shërbimit Social Shtetëror, të autorizuar për të përfaqësuar edhe MSHMS, si dhe znj. E.F, Drejtore e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë. Në seancë dëgjimore nuk u paraqit z. H.Ç, i cili nëpërmjet *e-mailit* të datës 01.06.2023, ka njoftuar se nuk

mund të paraqitej dhe seanca mund të zhvillohej në mungesën e tij, pasi ai e kishte depozituar dokumentacionin që dispononte në lidhje me ankesën.

Bazuar në pikën 9, të nenit 33, të LMD, përcaktohet se: “9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.” Bazuar në këtë kompetencë ligjore, si dhe duke vlerësuar qëndrimin e palëve gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri iu parashtrou palëve, nëse ata mund të arrinin një marrëveshje me pajtim në lidhje me problematikën e parashtruar nga ankuesi.

Përfaqësuesit e SHSSH, deklaruan se, në vijim të seancës dëgjimore do të bënin me dije Komisionerin në lidhje me qëndrimin e institucionit dhe mundësinë e arritjes së një marrëveshje pajtimi dhe zgjidhjen e problematikës së adresuar nga pala ankuese.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet *e-mailit* të datës 22.06.2023, SHSSH informoi se, në lidhje me rastin e A.Çt, vajzës së ankuesit, do të realizoheshin pagesat e kërkuara.
4. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 11.08.2023, DRSHSSH Korçë, informoi Komisionerin se, në muajin korrik 2023, ishin kryer të gjitha pagesat e shpërblimeve të vitit 2022 për A.Ç, vajzën e ankuesit. DRSHSSH Korçë, vuri në dispozicion të Komisionerit shkresën nr.3093 prot, datë 01.08.2023, të Bashkisë Pogradec, nëpërmjet të cilës rezultoi se, për shtetasen A. H.Ç janë paguar:
 - Paketa për mbështetje financiare prej 9.000 (nëntë mijë) lekë, shpërndarë gjatë muajve prill, maj, qershor 2022;
 - Shpërblimi për festat e fundvitit prej 3.000 (tre mijë) lekë, shpërndarë në muajin dhjetor 2022;
 - Paketa e rezistencës prej 8.000 (tetë mijë) lekë, shpërndarë gjatë muajit janar 2023.
5. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 11.08.2023, ankuesi H.Ç, deklaroi se: “Duke falenderuar institucionin tuaj që mundësoi zgjidhjen e çështjes së vajzës time A.Ç, ku nga ndërmjetësimi i institucionit tuaj morën zgjidhje edhe pagesat e shpërblimeve për vajzën time, kërkoj që çështja të pushohet, pasi unë i mora këto pagesa dhe nuk do të doja që procesi të shkonte më tej”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëron se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur dhe pala ankuese nëpërmjet *e-mailit* të datës 11.08.2023, kërkoj pushimin e çështjes dhe që procesi i shqyrtimit të kësaj ankese të mos vazhdojë, pasi e konsideron çështjen e adresuar pranë Komisionerit nëpërmjet ankesës objekt shqyrtimi, si të zgjidhur.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e

nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, përcaktohet: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 42 regjistri, datë 16.03.2023, të paraqitur nga z. H.Ç në emër të vajzës së tij të mitur A.Ç, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.42 Regjistri, datë 16.03.2023, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti